



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT



Nr. regjistri (JR) 20/2018

Tiranë, më 18.03.2019

Nr. 20/4 regj.

SHPLLJE

E

**NJOFTIMIT PËR ZHVILLIMIN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJES NË SEANCË
PUBLIKE**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se sot, më datë 18.03.2019, ora 09.30, pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen me numër regjistri (JR) 20/2018, datë 17.10.2018, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Rovena Gashi kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 48, datë 25.07.2018, bazuar në nenin 4, pika 6 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenin 51, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve, ditën **e enjte**, në datën **04.04.2019**, ora **10:00**.

Gjykimi në seancë publike u vendos për t’i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit, për t’u shprehur në lidhje me gjetjen dhe provat bashkëlidhur saj, të vëzhguesit ndërkombëtar të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, të paraqitur në Kolegjin e Posaçëm të Apelit me shkresë nr. 321 prot, datë 14.03.2019 dhe të protokolluar me nr. 357 prot., datë 15.03.2019.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjyqësor, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesues i Trupit Gjyqësor	Albana Shtylla
Relator i Çështjes	Luan Daci
Gjyqtar	Ardian Hajdari
Gjyqtar	Rezarta Schuetz
Gjyqtar	Sokol Çomo

Bazuar në nenin 460, pika 5 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 51, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, kjo shpallje bëhet të paktën 10 ditë para seancës gjyqësore, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe në faqen e internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**RELATORI I ÇËSHTJES
GJYQTAR**

Luan Daci



**KRYESUESI I TRUPIT GJYKUES
GJYQTAR**

Albana Shtylla